



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2023:258790

Datë: 28.12.2023

Numri i dokumentit: 05136949

PPP. nr. 83/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Astrit Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Remzi Duli në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit S.H nga Komuna e Gllogocit të cilin e përfaqëson B.Ç nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Gllogocit-Drejtoria e Arsimit, lidhur me borxhin në shumën prej 770.00 €, duke vendosur në prapësimin e ushtruar nga debitori kundër urdhërit për lejimin e përmbartimit të Përmbartuesit privat G.M, P.nr... të datës 20.10.2023, jashtë seancës me datën 27.12.2023 e mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET prapësimi i debitorit Komuna e Gllogocit-Drejtoria e Arsimit kundër urdhërit të Përmbartuesit Privat G.M nën shenjën P.nr... të datës 20.10.2023, me të cilin është lejuar propozimi i kreditorit S.H nga Komuna e Gllogocit për përmbartimin e borxhit në shumën prej 770.00 €, ndërsa urdhëri i Përmbartuesit Privat P.nr... të datës 20.10.2023 **mbetet në fuqi**.

A r s y e t i m

I autorizuari Kreditorit S.H nga Komuna e Gllogocit ka parashtruar propozim të Përmbartuesi Privat G.M, për lejimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të përmbartueshëm të Aktgjykimit C. nr. 341/20 e datës 14.12.2021 lidhur me pagesën e borxhit-kamatën ligjore siç është cekur në Aktgjykim C. nr. 341/20 në lartësi prej 770.00 €, me kamatë vjetore prej 8 %, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat 7 ditor në të kundërtën, të bllokohen llogaritë bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjete në llogari të bëhet regjistrimi, sekuestrimi, vlerësimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme e mjetet e mbledhura të derdhen në llogari të kreditorit.

Përmbartuesi Privat G.M duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të Aktgjykimit C.nr. 341/20 të datës 14.12.2021.

Debitori ka paraqitur prapësim kundër urdhërit për lejimin e përmbartimit në afatin ligjor me arsyetimin se: *fillimisht pala kreditore shumën e kërkuar ka mundur ta realizoj përmes*

propozimit për përmbarrim të dorëzuar pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Dega në Glllogoc e cila e mbanë shenjen CP.nr.119/2022 në të cilin propozim përveç borgjit kryesorre pala kreditorë ka kërkuar edhe kamatën prej 8%. Po ashtu thekson se nuk është i obliguar të paguaj kamatën pasi që është një lëshim i kreditorit me rastin e paraqitjes së propozimit për përmbarrim të mëparshëm, andaj ka kërkuar që në vështrim të Nenit 73 par. 3 të LPP-së të aprovohet si i bazuar prapësimi i tij dhe të refuzohet si i pa bazuar urdhëri për përmbarrim i përmbarruesit privat.

Kreditori në afatin ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim duke kundërshtuar prapësimin e debitorit në tërësi si të pa bazuar dhe të pa argumentuar me asnjë provë, duke i propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhëri P.nr... të datës 20.10.2023 të mbetet në fuqi.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është pa i bazuar, ndërsa kundërshtimet e prapësimit të dhëna nga kreditori në përgjigje në prapësim, gjykata i konsideroi si të qëndrueshme dhe atë për këto arsye.

Me shikimin e shkresave të lëndës gjykata e vërtetoi faktin se kreditori, propozimin për përmbarrim e ka bërë për përmbarrimin e dokumentit të përmbarrueshëm-të Aktgjykimit C. nr 341/20 i datës 14.12.2023 të lartëcekur për shkak të detyrimit në të holla si më lartë, i cili propozim është lejuar me urdhërin e Përmbarruesit Privat e me propozimin e mjeteve gjegjëse të përmbarrimit të parapara me dispozitat ligjore të LPP-së për realizimin e detyrimit në të holla që rrjedh nga Aktgjykimi si në rastin konkret.

Lidhur me atë se me çfarë baze juridike caktohet përmbarrimi, se çka përmban dokumenti i përmbarrimit, se çka duhet të përmbajë një propozim për përmbarrim të dokumentit të përmbarrueshëm-Titull ekzekutiv si aktgjykimi i lartëcekur, si dhe kushtet ligjore për caktimin e përmbarrimit në bazë të dokumentit të besueshëm janë të përcaktuara me dispozitat ligjore të Nenit 21, 22, 29, 30, 37, 38 dhe 40 të LPP-së, ndërsa shkaqet e prapësimit janë përcaktuar në Nenin 71 të LPP-së, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të përmbarrueshëm nga i cili shihet se debitori i ka borxhin në fjalë kreditorit.

Debitori në prapësimin e tij ka pretenduar se nuk ka obligim ndaj kreditorit gjykata nuk e aprovoj këtë pretendim pasi që nuk ka bazë ligjore, ndërsa kreditori në anën tjetër, propozimit për përmbarrim i ka bashkangjitur Aktgjykimin C.nr.341/20 të datës 14.12.2021 i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm vendosur nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc si më lartë, i cili i plotëson kushtet ligjore për të u trajtuar dokument i përmbarrueshëm në kuptim të Nenit 22 par. 1.1 të LPP-së.

Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e refuzuar prapësimin e debitorit dhe ka lene ne fuqi urdhërin përmbarrues për caktimin e përmbarrimit duke u bazuar në Nenin 73 par. 3 të LPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Dega në Glllogoc
Departamenti i Përgjithshëm, PPP. nr. 83/23, datë 27.12.2023**

**Gj y q t a r i
Astrit Gashi**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.